

Titulli i lëndës: HYRJE NË TEORI TË MEDIAS

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Hyrje në Teori të Medias
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	2025-2026
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Arben Fetoshi
Të dhënat kontaktuese:	arben.fetoshi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	“Hyrje në Teori të Medias” është lëndë semestrale që ofron njohuritë themelore mbi natyrën, funksionet dhe evoluimin e teorive mbi median si një faktor kyç për informimin publik dhe zhvillimin socio-kulturor të shoqërisë. Përmbajtja e kësaj lënde është e bazuar në bibliografinë e autorëve perëndimorë, por me një strukturim të përshtatur për studentët e nivelit Bachelor të Gazetarisë. Duke shqyrtuar konceptet, modelet dhe teoritë kryesore që kanë ndikuar në studimet e medias, nisur nga teoritë klasike deri te qasjet bashkëkohore kritike, studentët do të kuptojnë se si mediat e formësojnë realitetin, ndikojnë opinionin publik dhe ndërveprojnë me strukturat politike, ekonomike e kulturore të shoqërisë. Vëmendje e veçantë do t’i kushtohet relacionit mes teorisë normative dhe realitetit mediatik, në mënyrë që studentët ta kuptojnë sa më qartë logjikën e medias në kontekstin e sfidave të transformimit që ka diktuar epoka digjitale. Lënda “Hyrje në Teori të Medias” është dizajnuar si një kornizë e përgjithshme për të nxitur mendimin kritik, aftësitë analitike dhe ndërgjegjësimin e studentëve mbi rolin e medias në shoqëritë demokratike.

Qëllimet e lëndës:	Nëpërmjet ligjëratave dhe detyrave seminarike, duke u njohur me dimensionin socio-kulturor të medias dhe rëndësinë e saj për proceset demokratike, studentët do të përgatiten për kompetencë sa më të lartë profesionale në fushën e azetarisë. Në këtë funksion, ata do të pajisen me dije dhe aftësi analitike mbi rolin e medias dhe ndikimin e saj në raport me proceset politike, kulturore dhe demokratike në shoqëri. Temat janë përcaktuar në bazë të evoluimit kronologjik dhe perspektivave të ndryshme shkencore, duke fokusuar kontekstin socio-politik të Kosovës, me qëllim që studentët ta kuptojnë më lehtë zhvillimin dhe transformimin e medias si faktor i pazëvendësueshëm për funksionimin demokratik të shoqërisë.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të: - Identifikojnë dhe shpjegojnë ndikimin e faktorëve politikë, ekonomikë e kulturorë në prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve mediale;		
	- Aplikojnë dijet e fituara në detyra të ndryshme profesionale që lidhen me analizën e medias dhe raportimin;		
	- Njohin dhe përshkruajnë ndërveprimin e medias me audiencën në kontekst të formësimit të opinionit publik;		
	- Analizojnë dhe vlerësojnë rolin e medias, përkatësisht sfidat e gazetarisë në kontekst të zhvillimeve teknologjike, politike e demokratike të shoqërisë;		
	- Ndërtojnë bazë teorike për analizwn e përmbajtjeve mediale.		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	1	2
Konsultime me mësimdhënësin	40 min.	15	10

Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	10	2	20
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			146:25=5.84
Metodat e mësimdhënies:	Lënda “Hyrje në Teori të Medias” do të zhvillohet me metodë të kombinuar duke përfshirë ligjëratat, diskutimet në formë debati dhe punën e studentëve në përgatitjen e detyrave të përcaktuara.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të formulës së mëposhtme: 1. Pjesëmarrja aktive 10 % 2. Ushtrime (detyrat) 20 % 3. Kolofiumi / Seminari 20 % 4. Provimit përfundimtar 50 % TOTALI: 100 % • Pjesëmarrja në orët e lëndës nuk nënkupton vetëm vijueshmërinë. Studentët do të vlerësohen në bazë të cilësisë së komenteve, vëmendjes, qëndrimit dhe sjelljes në klasë. • Në kuadër të ushtrimeve studentët janë të obliguar t’i realizojnë detyrat individuale ose në grupe si: Analizë / Ese / Studim Rasti. • Seminari është punim hulumtues për një temë të caktuar, të cilin studenti e dorëzon deri në fund të semestrit.		
Literatura primare:	1. Laughey, Dan (2007). MEDIA STUDIES - Theories and Approaches, Kamera Books 2. Zeneli, Alban (2021). Media tradicionale përballë medias së re, OLYMP, Prishtinë 3. Griffin, Em& al. Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit, botimi i nëntë, Educational Centre		

Literatura shtesë:

1. FRED S. SIEBERT, THEODORE PETERSON, WILBUR SCHRAMM (2011). FOUR THEORIES OF THE PRESS, Originally published 1956
2. DANIEL C. HALLIN, PAOLO MANCINI (2012). Comparing Media Systems Beyond the Western Worldm Cambridge University Press
3. Fetoshi, Arben (2018). Media dhe Integrimi Europian, ORFEU, Prishtinë
4. Holmes, David. (2005). Communication Theory: Media, Technology and Society. United Kingdom: SAGE Publication.
5. McLuhan, Marshall. Instrumentet e Komunikimit – Media sizgjatiminjeriut, Instituti i Dialogut dheKomunikimit - IDK, Tiranë

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	• Hyrje në Teori të Medias (konceptet bazë, roli i teorisë në studimin e medias)
Java 2:	• Teoria e Efekteve të Drejtpërdrejta (Shiringa Hipodermike, Plumbi Magjik – Modeli i Propagandës)
Java 3:	• Teoria e dy hapave (Two Step Flow) (Roli i liderëve të Opinioneve - Lazarsfeld dhe Katz)
Java 4:	• Teoria e Përdorimeve dhe Kënaqësive (Kalimi nga audience passive në audiencën aktive)
Java 5:	• Teoria Kritike (Shkolla e Frankfurtit – Adorno, Marcuse, Horkheimer)
Java 6:	• Teoria Normative e Medias (Modelet dhe aplikimi i tyre në shoqëri)
Java 7:	• Determinizmi Teknologjik (Teoria Ekologjike e McLuhan-it)
Java 8:	• Testi Intermediar
Java 9:	• Teoria e Kultivimit (Ndërtimi i realitetit përmes televizionit - Gerbner)
Java 10:	• Teoria e Caktimit të Agjendës dhe Kornizimi (Ndikimi i medias në rëndësinë dhe kuptimin e temave – McCombs dhe Show)
Java 11:	• Spiralja e Heshtjes (Media dhe autocenzura - Noelle-Neumann)

Java 12:	• Studimet Kulturore (Modeli Kodifikim/Dekodifikim – Stuart Hall)
Java 13:	• Opinioni Publik dhe Sfera Publike (Nga Lippman-i deri te Habermas-i)
Java 14:	• Media në Kosovë (Liria dhe Pluralizmi si indikatorë në procesin e integritit evropian – Arben Fetoshi)
Java 15:	• Diskutim përmbledhës për lëndën

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të marrë shënime; aktivitete të tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi. Nga të gjithë pritët të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bënë të përdorët gjuhë e pahijshme. Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit.